



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.25.1-2018-08

**RAPORTI AUDITIMIT PËR KOMUNËN E ZUBIN POTOKUT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Zubin Potokut*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Xhevat Seferi - Udhëheqës Ekipi dhe Stana Danqetoviq e Nebojsa Ristiq anëtar të ekipit*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Zukë Zuka*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	24
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	33
Shtojca II: Letër Konfirmimi	35

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës së Zubin Potokut për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 15/01/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Komuna nuk ka regjistruar dhe shpalosur në PFV pasuritë e trashëguara dhe të blera nga vitet e mëparshme si dhe të blera gjatë vitit 2018.
- Kontratat e punës për 35 punonjës nuk janë azhurnuar. Komuna nuk ka ofruar kontrata të reja për punonjësit, të cilët vazhdojnë të paguhen përmes listës së pagave.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Procesi i përgatitjes së PFV-ve është menaxhuar në përgjithësi në përputhje me kërkesat ligjore. Megjithatë, theksimi i çështjes për menaxhimin dhe raportimin e pasurisë dhe personelit, ende mbetet sfiduese për komunën.



Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve për vitin 2019 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit përgjegjës, dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih theksimin e çështjes në opinionin e auditimit).

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të investimit kapitalë është në nivel të ulët. Më tutje vazhdojnë të ekzistojnë dobësi në sistemet financiare, duke përfshirë: paga dhe mëditje, subvencione, menaxhimi i të hyrave vetjake, si dhe sistemi i auditimit të brendshëm.



Kryetari duhet të sigurohet se është kryer një vlerësim i detajuar në fushat brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për përsëritjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet tek kapitulli 3.1 dhe 4.1).

Përkundër veprimeve për hartimin e planit të veprimit, rekomandimet kyçe nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin organizatës.



Kryetari duhet të sigurohet se ka filluar të zbatohet një proces rigoroz për të konfirmuar që rekomandimet e viteve paraprake po zbatohen në mënyrë aktive dhe progresi të raportohet tek menaxhmentit në baza mujore (shih kapitullin 5).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Aktiviteti i auditimit të brendshëm nuk është themeluar, për t'i mbështetur zhvillimet në këtë fushë.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike dhe të ndërmarr veprimet e duhura për përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për të gjitha çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme (shih çështjen B8).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Zubin Potokut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna nuk ka regjistruar dhe shpalosur në PFV pasuritë e trashëguara dhe të blera nga vitet e mëparshme si dhe të blera gjatë vitit 2018 në kategorinë e investimeve kapitale në vlerë prej 1,633,586€. Kjo ndërlidhet me mungesën e regjistrimit të pasurive dhe vlerësimin e pronës komunale.

- Kontratat e punës për 35 punonjës të komunës, nuk janë azhurnuar. Nga komuna nuk kishte sqarime se pse ka ndodhur kjo gjë përveç sqarimit se kjo gjendje është nga koha e administrimit të UNMIK-ut.

Për çështjet e theksuara, me lart ne kemi rekomanduar edhe vitin e kaluar, megjithatë menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime konkrete.

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se:

- Komuna nuk i posedon planet/strategjitë, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj;
- Sfidat në menaxhimin e personelit, mangësi në zbatimin e strukturës organizative si dhe kërkesat tjera që ndërlidhen me zbatimin UA-ve përkatëse;
- Komuna ende nuk ka vendosur politika për zbatimin e ligjit për Tatimin në pronë si dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e të hyrave nga kjo veprimtari. Po ashtu, nuk zbatohet ligji për ndërtimet dhe nuk arkëtohen të hyra nga lejet e ndërtimit, apo për shfrytëzim të pronave/hapësirave komunale etj; dhe
- Ekzekutimi i buxhetit për investime kapitale dhe atë kryesisht nga Fondi për Zhvillim është i ulët si pasojë e vonesave në aprovimin e projekteve kapitale të komunës nga Bordi përkatës i këtij fondi.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Zubin Potokut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 (shpenzimet publike) dhe 02/2013 (Menaxhimi i pasurisë);
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Kërkesat për planifikime buxhetore; dhe
- Kërkesa për raportim dhe barazime tremujore me Thesar për ecurinë e të hyrave dhe shpenzimeve.

Lidhur me PFV-ve, përveç mos shpalosjes së pasurive, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera për të përmirësuar cilësinë e tyre, si: shpalosjet për obligimet e papaguara, për të hyrat e bartura, dhe për shpalosjet e fondit zhvillimor.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve të korrigjuara në Ministrinë e Financave, mund të

konsiderohet e saktë përveç shpalosjeve të pasurisë. Si pasojë e neglizhencës së menaxhmentit për tu marr me menaxhimin e pasurisë, mungon edhe regjistri i pasurisë siç kërkohet me UA 02/2013. Në anën tjetër menaxhmenti përmend edhe vështirësinë për të regjistruar pasuritë e mëhershme të trashëguara (objektet publike), si dhe shkaqeve tjera administrative. Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë si në vijim:

- Kërkesa e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK) nuk është përmbushur, si dhe nuk ka një vlerësim dhe plan për monitorim të rreziqeve;
- Obligimet e pa paguara nuk raportohen në baza mujore; dhe
- Nuk raportohet në baza mujore për ecurinë e procesit të investimeve kapitale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendu jepen rekomandimet:

Rekomandimi B1 ¹Kryetari duhet të ndërmerr veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet dhe për të siguruar menaxhim të duhur të pasurive dhe të kontratave të dosjeve të punonjësve. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet kanë filluar të përmirësohen, veçanërisht në fushën e procedurave të prokurimit. Megjithatë, një sërë fushash kërkojnë

¹ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

përmirësim të mëtejshëm. Në vitin 2018, komuna kishte një performancë jo të kënaqshme buxhetore ku vetëm 68% e buxhetit final ishte shpenzuar, që paraqet një ngritje prej 5% krahasuar me atë të vitit paraprak. Performanca buxhetore ishte ndikuar nga vonesat në aprovimin e projekteve nga Fondi për Zhvillim si dhe vonesat në përfundim të projekteve.

Gjithashtu, në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi nuk janë të përshtatshme dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i personelit, menaxhimi i subvencioneve, si dhe performanca e dobët në arkëtimin e të hyrave.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,503,574	4,084,335	2,796.040	2,173,627	1,686,669
Granti i Qeverisë -Buxheti	2,493,756	2,991,836	2,469,797	1,978,664	928,982
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	16,464	16,396	15,901	-
Të hyrat vetjake ⁴	9,818	9,818	-	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim	-	1,066,217	309,847	179,062	757,687

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,580,761€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së fondeve nga Fondi zhvillimor në mirëbesim në shumën prej 1,066,217€, të hyrave të bartura nga viti paraprak prej 16,464€, si dhe i rritjes së aplikuar pas aprovimit të një projekti kapital nga Bordi i fondit për zhvillim ekonomik në vlerë prej 498,080€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 68% të buxhetit final me një suficit prej 1,288,295. Në krahasim me vitin 2017 ka një përmirësim prej 5%, megjithatë realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,503,575	4,084,335	2,796,040	2,173,627	1,686,670
Pagat dhe Mëditjet	1,253,202	1,253,202	796,075	749,232	662,770
Mallrat dhe Shërbimet	258,555	275,019	257,681	201,489	205,931
Shërbimet komunale	67,062	67,062	17,948	2,710	-
Subvencionet dhe Transferet	91,104	91,104	90,750	90,100	40,560
Investimet Kapitale	833,652	2,397,948	1,633,586	1,130,096	777,409

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit final, realizimi i tij ishte i ulët (vetëm 68%) veçanërisht tek kategoria për investime kapitale, ku vetëm 68% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe pesë projekte të reja për vitin aktual. Megjithatë, vonesat në zbatim janë gjithashtu të dukshme në projektet e filluara para vitit 2018. Më tutje, nga Fondi për Zhvillim nga tri projekte të aprovuara në vitin 2017 një nuk ka filluar fare⁵, ndërsa për dy të tjera⁶ fondet ishin aprovuar me vonesë dhe mjetet financiare nuk i ishin ndarë komunës me kohë e pastaj procedurat e prokurimit nuk kanë filluar me kohë në vitin 2018. Sidoqoftë, suficiti domethënës kundrejt buxhetit të rritur në këtë kategori është edhe për shkak të vonesave në ekzekutimin e projekteve edhe nga vitet e kaluara të cilat financohen nga Fondi Zhvillimor dhe barten nga viti në vit;
- Buxheti për paga dhe mëditje nuk ka pësuar ndryshim nga ai fillestar, megjithëse shpenzimi i tij ishte realizuar vetëm 64% dhe kjo ka ndodhur për shkak të mos pagesës së pagave për punëtorët në sektorin e arsimit dhe atij të shëndetësisë;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshin gjithashtu të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm prej 16,464€. Këtu përfshihen edhe shërbimet komunale dhe niveli i ekzekutimit të buxhetit është ende i ulët. Niveli i ekzekutimit për mallra dhe shërbime ishte 94% ndërsa tek pjesa e shpenzimeve komunale vërehet nivel i ulët i ekzekutimit vetëm 27%; dhe
- Buxheti për subvencione është realizuar pothuajse 100% dhe ka të bëjë me subvencionimin e personave fizik (entiteteve jo publike).

⁵ Projekti "Zhvillimi ekonomik lokal" në vlerë 409,000€

⁶ "Qendra për sporte ujore në liqenin e Ujmanit" në vlerë 350,000€ dhe "Furnizimi me pajisje medicinale për Qendren Mjekësore" në vlerë 161,650€.

Sa i përket planifikimit në arkëtimin e të hyrave, komuna ka planifikuar të arkëtoj 9,818€, ndërsa ka arkëtuar vetëm 2,598€ nga taksat administrative.

Çështja B2 - Ekzekutimi i ulët i buxhetit

Gjetja Sipas planifikimit dhe aprovimit të buxhetit për vitin 2018 është përcaktuar buxheti për realizim për Komunën e Zubin Potokut (shih tabelën nr.1). Megjithatë, realizimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur, ku vetëm 68% e buxhetit ishte realizuar. Posaçërisht nivel i ulët i realizimit ishte tek kategoria për investime kapitale, ajo për mallra dhe shërbime dhe në paga dhe mëditje. Një pjesë e madhe e shpenzimeve janë bërë në tre mujorin e fundit të vitit (42% e shpenzimeve). Kjo ka ndodhur për shkak të një planifikimi të dobët dhe të pabazuar në objektiva të qarta dhe pa një analizë konkrete të shkaqeve që për vite me radhë ka dallime mes planifikimit dhe realizimit buxhetor.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i buxhetit, do të ndikojë në mos arritjen e objektivave të organizatës, shërbime dhe infrastrukturë të dobëta për qytetarë, humbjen e kredibilitetit ndaj qytetarëve dhe donatorëve potencial, si dhe në humbjen e investimeve nga investitor potencial.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore monitorohet vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson pengesat dhe vështirësitë për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

Çështja A1- Pagesa nëpërmjet vendime gjyqësore**Gjetja**

Sipas nenit 40 të LMFPP-së, Thesari ka ekzekutuar dy pagesa në vlerë prej 20,390€ nga buxheti i komunës direkt në llogari të përfituesve. Pagesat ishin si rezultat i mosmarrëveshjes në mes Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe Komunës për punëtorët e njësisë së zjarrfikësve (nëntë veta), të cilët duhej të transferoheshin tek komuna. Komuna nuk ka pasur pozita të buxhetuara dhe lejuara tek njësia e zjarrfikësve, kështu që kanë mbetur jashtë listës së pagave. Komuna nuk ka ushtruar të drejtën e saj për tu mbrojtur pasi nuk ka Zyrtar ligjor të punësuar, si dhe nuk e ka kundërshtuar vendimin gjyqësor. Kjo ka rezultuar me një obligim prej gjithsej 88,470€ nga të cilat 68,080€ kanë ngelur si obligime për tu paguar në vitin 2019.

Pagesat i ishin bërë nga kategoritë e gabuara ekonomike, ku njëra pagesa në vlerë 13,283€ ishte nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa tjetra 7,107€ nga Investimet kapitale, përderisa komuna kishte kërkuar që ato mjete të paguheshin nga paga dhe mëditje.

Sipas menaxhmentit të komunës, deri tek kjo situatë ka ardhur për shkak se komuna ka njësinë e saj të zjarrfikësve dhe nuk ka pasur mundësi të sistemoj zyrtarë tjerë si zjarrfikës, pasi nuk ishin planifikuar ato pozita me buxhetin e komunës. Gjithashtu edhe komunikimi i mirëfilltë në mes institucioneve ka munguar.

Rreziku

Situata të tilla kur ka konteste në mes komunës dhe palëve tjera dhe kur komuna nuk e shfrytëzon mundësinë e ushtrimit të mbrojtjes ligjore do të ndikojnë që të kryhen pagesa të pa planifikuara dhe e rëndojnë buxhetin e komunës. Gjithashtu, pagesat e ekzekutuara nga Thesari nga kategori ekonomike jo adekuate, do ta vendosin komunën në vështirësi për të kryer projektet e saj kapitale, respektivisht furnizimet me mallra dhe shërbime të nevojshme.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të siguroj që në strukturën organizative të ketë njësinë ligjore, respektivisht një zyrtar ligjor në mënyrë që në konteste gjyqësore të ketë përfaqësim të mbrojtjes ligjore. Më tutje, duhet të kërkoj nga Thesari që të zbatoj rregullat financiare që të mos vijë në situatë që të kryhen pagesa direkte pa u zbatuar procedura për obligimet e pa paguara. Po ashtu, Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për zgjidhjen e statusit të punëtorëve të zjarrfikësve, njëkohësisht këtë situatë ta trajtojë me organet tjera kompetente dhe të eliminojnë kontestet e tilla, në mënyrë që mos vijë deri tek dëmtimet buxhetore për pagesën e ngarkesave shtesë të shpenzimeve për procesin gjyqësor.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2018 ishin në vlerë 2,598€ (duke mos i llogaritur gjobat e gjykatave dhe të policisë në vlerë 22,647€). Burimet e arkëtimit direkt të të hyrave vetjake janë të kufizuara vetëm në këto kategori: nga taksat administrative dhe nga taksat për certifikata të gjendjes civile. Komuna ende nuk është duke aplikuar kërkesat ligjore të ngarkesave për tatimin në pronë, lejet e ndërtimit, shfrytëzimin e pronave publike etj.

Shpjegimet për planifikimin dhe realizimin e të hyrave janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat e arkëtuara nga komuna	9,818	9,818	2,598	1,769	2,495
Gjithsej të hyrat vetjake	9,818	9,818	2,598	1,769	2,495

Çështja B – Moszbatimi i ligjit për tatim në pronë, ligjit për ndërtime dhe mungesa e rregulloreve të brendshme për taksa, tarifa dhe ngarkesa

Komuna nuk inkason të hyra nga tatimi në pronë dhe nga lejet ndërtimore. Për komunën, ende është sfiduese zbatimi i ligjeve që kanë të bëjnë me arkëtimin e të hyrave nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit dhe legalizimi i ndërtimeve, të hyrat nga shfrytëzimi i pronave komunale dhe publike, si dhe të hyrat nga taksat e ndryshme administrative. Për më tepër, komuna ende nuk ka vendosur politika në zbatim të tyre.

Më tutje, komuna ende nuk ka një rregullore të brendshme të aprovuar nga Kuvendi Komunal për taksa, tarifa dhe ngarkesa për shërbimet që u ofron qytetarëve të saj. Komuna, ende bën arkëtimin e të hyrave duke u bazuar në një vendim të aprovuar nga Mitrovica Veriore. Për më tepër, ky vendim nuk parasheh të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, shfrytëzimin e pronave publike apo burime tjera të të hyrave komunale. Prandaj edhe niveli i mbledhjes së të hyrave vetjake është simbolike.

Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk është i interesuar dhe i vendosur të zbatoj këto kërkesa ligjore për arkëtim të të hyrave vetanake dhe është e ndikuar kryesisht nga moszgjidhja e problemeve administrative.

Rreziku

Mos zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimeve në pronë, taksave për leje të ndërtimit dhe të taksave e tarifave tjera nga ana e komunës, pasqyron një qasje joserioze për të aplikuar kërkesat ligjore në këtë fushë. Kjo rritë rrezikun e pa pajtueshmërisë me ligjet e aplikueshme dhe redukton të hyrat vetjake, si dhe mundësinë e financimit të projekteve nga ky burim i të hyrave.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike, si dhe e njëjta të aprovohet në Kuvendin komunal. Po ashtu, të siguroj zbatimin e ligjit për tatimin në pronë dhe atij të ndërtimit, i cili ka për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave minimale ligjore, dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Menaxhimi i burimeve njerëzore ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve të organizatës për të siguruar funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe të kuvendit komunal, të cilat zbatohen në gjithë organizatën. Menaxhimi i burimeve njerëzore përfshinë: hartimin dhe rishikimin e strukturës organizative, kategorizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, kontrollin e kostove buxhetore të personelit, si dhe kontrollin e procesit të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të personelit, duke përfshirë këtu edhe matjen e efektivitetit të personelit përmes vlerësimit të performancës së kryerjes së detyrave.

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 1,253,202€ prej të cilave janë shpenzuar vetëm 796,075€. Kjo ka ndodhur për shkak të mos pagesës së pagave për punëtorët në sektorin e arsimit dhe atij të shëndetësisë.

Çështja C 1 – Dobësi në menaxhimin e personelit

Gjetja Menaxhmenti edhe pse në shkurt të vitit 2018 ka miratuar një Rregullore të brendshme për strukturën organizative, sistematizim të vendeve të punës dhe harmonizimin e saj me nevojat dhe buxhetin e komunës, ajo ende nuk ka filluar së zbatuari. Kjo ka ndikuar që disa pozita kyçe të mos plotësohen⁷.

Nga shqyrtimi i 65 dosjeve të personelit, ne kemi identifikuar se dokumentacioni i kërkuar me Rregullore për dosjet dhe regjistrin qendror të nëpunësve civilë 03/2011, për 30 raste ishte i pa kompletuar, ku kryesisht mungonin përshkrimi i detyrave të punës, vlerësimet vjetore të performancës, etj. Ndërsa në 35 raste, mungonin kontratat e punës dhe nuk ka dosje të punëtorëve. Kjo pasqyron një mungesë të specifikave të qarta për stafin e Burimeve Njerëzore (BNj) që ndërlidhen me zbatimin e kërkesave të UA-ve si pjesë e përshkrimit të detyrave të tyre të punës. Kjo ka ndodhur pasi që me vones është caktuar menaxherin për Burime Njerëzore (BNj), dhe deri në shkurt të viti 2018 nuk ka pasur të miratuar Rregulloren e brendshme për strukturën organizative.

Nga komuna nuk kishte sqarime se pse ka ndodhur kjo gjë përveç sqarimit se kjo gjendje është nga koha e administrimit të UNMIK-ut.

⁷ Pozitat e disa punëtorëve pa kontrata: Zyrtar i arsimit, Zyrtar për buxhet dhe financa, Zyrtar komunal për çështje gjinore, Udhëheqës i sektorit në shëndetësi, etj.

Rreziku Mos zbatimi strukturës organizative të personelit dhe mos emërimi i menaxherit të burimeve njerëzore, nuk ofron siguri në organizimin e brendshëm të komunës, njëkohësisht në ndarjen e detyrave dhe përshtatshmërinë e vendeve të punës. Mangësitë e paraqitura në mirëmbajtjen e dosjeve dhe mos përcaktimi i zyrtarëve në pozitat e rregullta, do të rezultojnë me kontrole të dobëta në menaxhimin e BNj. Mos përshkrimi i detyrave/përgjegjësive të punonjësve mund të ketë ndikim negativ në performancën e tyre dhe të organizatës në përgjithësi. Kjo gjithashtu pamundëson identifikimin e fushave për përmirësim dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për t'i adresuar në mënyrë urgjente çështjet e përmendura më lart, ashtu që komuna të zbatoj Rregulloren e brendshme për strukturën organizative dhe që pozitat kyçe të plotësohen me personelin adekuat dhe me një përshkrim të qartë të detyrave dhe përgjegjësive.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 342,081€. Prej tyre ishin shpenzuar 275,629€. Ato kanë të bëjnë me furnizimin me pajisje dhe inventar, furnizime zyre, shërbime të kontraktuara, karburant, pajisje mjekësore, mirëmbajtje të ndërtesave të zyrave, telefonit etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti për Subvencione dhe transfere, ndahet kryesisht për entitete publike, entitete jo publike dhe përfitues individual. Shembuj të subvencioneve janë subvencionet për sport, ndihmë për rastet sociale, subvencione në bujqësi, etj.

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 91,104€. Prej tyre në vitin 2018 ishin shpenzuar 90,750€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndihma për individë si raste sociale.

Çështja B4 - Menaxhimi i dobët i ndarjes së subvencioneve

Gjetja Komuna ka nxjerrë një rregullore për dhënien e subvencioneve, megjithatë, kjo rregullore nuk ka kritere të qarta për monitorimin e tyre. Më tej, në nëntë mostra të shqyrtuara, përfituesit e subvencioneve nuk kishin dërguar tek komuna raporte kthyesë për të konfirmuar se subvencioni i dhënë është shpenzuar për qëllimin për të cilin është dedikuar. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka kërkuar informata kthyesë nga përfituesit se si janë shpenzuar mjetet.

Rreziku Dështimi në monitorimin e subvencioneve, përkatësisht, mos raportimi i përfituesve, rritë rrezikun që subvencionet të mos ndahen për qëllime adekuate, pa kritere dhe në bazë të interesave të ndryshme, apo në mënyrën tjetër, në mos arrijten e qëllimit për të cilin janë dedikuar.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj që do të përcaktohen qartë në rregullore mekanizmat se si do të monitorohen dhe menaxhohen subvencionet. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,397,948€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 1,633,586€ ose 68% e buxhetit. Ky nivel i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale ishte për shkak se tri projekte të aprovuara nga Bordi i fondit për zhvillim ekonomik ishin aprovuar me vonesë në dhjetor të vitit 2017, dhe ishin bartur për tu kryer në vitin 2018. Dy nga këto projekte kanë filluar të zbatohen dhe nuk janë përfunduar ende pritet të realizohen në vitin vijues, ndërsa projekti për "Zhvillim ekonomik lokal" nuk ka filluar ende. Shpenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës në shëndetësi, arsim, si dhe infrastrukturës rrugore. Komuna gjithashtu një pjesë të investimeve kapitale i ka shpenzuar edhe përmes Fondit për Zhvillim Ekonomik.

Komuna me plan të prokurimit kishte planifikuar njëzet e gjashtë procedura të prokurimit për projekte kapitale dhe të njëjtat i ka realizuar (nënshkruar).

Çështja A2 - Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve

- Gjetja** Sipas ligjit LMFPP është përcaktuar se të gjitha shpenzimet duhet të kryhen sipas Planit kontabël në kategori dhe kode adekuate. Ky plan azhurnohet çdo vit kur ka ndryshime të kodeve ekonomike (futje apo heqje të tyre).
- Projekti i financuar nga Fondi zhvillimor për komunat veriore të Kosovës, “Sanimi i rrjetit të rrugëve lokale të komunës” vlera e projektit 426,223€, komuna në vitin 2016 ka shpallur konkurs për punësim të 160 punëtorëve për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, e cila ishte bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës. Planifikimi dhe pagesa e tyre (pagave për 12 muaj të vitit 2017 në vlerë 170,962€), ishte kryer gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale (kodi 31910 Avans për investime), derisa kodi adekuat i tyre ishte 11400 – Punëtorët jashtë listës së pagave. Edhe në vitin 2018 ka vazhduar kjo mënyrë e pagesës, por vetëm për një muaj dhe vlera e keq klasifikimit ishte 16,091€, pasi projekti ka përfunduar. Kjo ka ndodhur për shkak se buxheti ka qenë i gabuar pasi tërë shuma e projektit ishte buxhetuar për tu shpenzuar nga Investimet kapitale dhe nuk është bërë ridestnimi i mjeteve.
- Rreziku** Pagesat nga kode të gabuara ekonomike mund të ndikojnë në paraqitje jo të drejtë të informatave në PVF. Përveç kësaj përdorimi i fondeve të një kategorie të shpenzimeve për shpenzime të kategorisë tjetër do të ndikojnë në implikime buxhetore të komunës.
- Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se planifikimi i buxhetit për projekte kapitale të jetë në përputhje me shpenzimet të cilat konsiderohen si investime kapitale dhe të jenë të realizuara sipas destinimit në kategori ekonomike përkatëse. Në raste konkrete të bëhet ridestnimi i mjeteve për shpenzim sipas kërkesave të planit kontabël.

Çështja A3- Vonesa dhe mos fillimi i projekteve kapitale

Gjetja Në përputhje me planifikimet buxhetore, planin e prokurimit, Planet dinamike të kryerjes së punëve dhe në përputhje me kontratat, marrëveshjet e nënshkuara, projektet kapitale duhet të kryhen pa vonesa.

Komuna nga Fondi për zhvillim ka pasur në dispozicion për projekte kapitale 1,066218€ nga viti 2017 dhe 498,079€ të aprovuara në vitin 2018, pra gjithsej 1,564296€, nga të cilat ka shpenzuar 807,419€ dhe i ka bartur për shpenzim 756,878€ . Projekti “Qendra për sporte detare dhe ujore tek Liqeni Gazivodes:” 178,088€. nuk është kryer ende. Ky projekt ishte planifikuar që të kryhet për 120 ditë pune (plani dinamik). Si rezultat i fillimit me vonesë të punimeve për shkak të reshjeve atmosferike (korrik) dhe rrëshqitjeve të dheut. Pra ka vonesa të theksuara. Punëkryesi në sezonin e dimrit kishte kërkuar ndërprerje të punimeve dhe zgjatje të afatit kryerjes së projektit edhe për 60 ditë, e cila ishte miratuar nga kryetari i komunës. Komuna nuk ka aplikuar ndëshkime për vonesa pasi që ato nuk janë shkaktuar nga punëkryesi dhe nuk kanë mundur të menaxhohen as nga Menaxhmenti i komunës për shkak të ndikimeve të kushteve madhore.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka kryer paraprakisht një studim fizibiliteti, siç kërkohet me Rregulla e Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik për këtë projekt për të evituar rreziqe të rrëshqitjes së dheut, si dhe nuk ka arritur që të siguroj fillimin e punëve me kohë.

Gjithashtu, projekti “Zhvillimi ekonomik lokal” në vlerë 409,000€ të aprovuar në vitin 2017 nga Bordi për fondin zhvillimor komuna nuk ka filluar ende. Kjo kishte ndodhur për shkak se (sipas komunës) nuk kanë gjetur modalitetin e duhur si të kryejnë këtë projekt, pasi nuk kanë pasur përvoja me projekte të tilla që kanë të bëjnë me përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla për të zhvilluar veprimtarinë e tyre ekonomike, kryesisht ekonomi familjare.

Rreziku Mos fillimi me kohë i projekteve, si dhe mos kryerja paraprake e studimit të fizibilitetit, do të ndikoj me vonesa në kryerjen e punimeve, si dhe mund të ndikoj edhe me ndonjë shpenzim shtesë gjatë ekzekutimit të projektit. Më tutje, mos planifikimi i mënyrës së zbatimit të projektit para paraqitjes për aprovim të propozim-projekteve do të ndikoj në mos realizim të projekteve apo edhe në penalizime nga OE. Të gjitha këto situata mund të ndikojnë në vlerën e dobët për para dhe mos arritje të objektivave.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurohet që për projekte përkatëse të kryhet paraprakisht studim fizibiliteti, të siguroj që projekti të fillojnë në kohë optimale dhe që planet për kohëzgjatjen e punimeve të jenë të planifikuara në përputhje me mundësitë reale. Po ashtu, gjatë përgatitjes së Propozim-projekteve kapitale komplekse të gjej modalitete të përshtatshme se si të ekzekutohet projekti në mënyrë që të evitohen vonesa në fillimin dhe kryerjen e atyre projekteve.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre, si dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Çështja B5 – Menaxhimi i dobët i pasurive

Gjetja Komuna edhe pse në vitin e kaluar kishte emëruar një zyrtar për identifikimin dhe regjistrimin e pasurive, ende nuk ka ndërmarr asnjë veprim lidhur me regjistrimin, inventarizimin dhe menaxhimin e pasurive mbi dhe nën 1,000€ (përfshirë stoqet) siç parashihet me UA 02/2013. Komuna nuk ka formuar komisionet përkatëse për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurisë. Kjo çështje ishte trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm dhe janë dhënë rekomandimet e duhura, por asnjë veprim nuk është ndërmarrë në këtë drejtim, prandaj si çështje është theksuar në opinionin e auditimit. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së menaxhmentit për tu marr me këtë çështje, por menaxhmenti përmend edhe vështirësinë për të regjistruar pasuritë e mëhershme të trashëguara (objektet publike), si dhe shkaqeve tjera administrative.

Rreziku Menaxhimi i dobët i pasurive, rezulton me mos identifikimin, ekzistencën dhe mos paraqitjen e drejtë dhe faktike të pasurive në PFV. Po ashtu, kjo situatë rritë rrezikun për humbje, tjetërsim apo edhe keqpërdorim të pasurive.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar dhe që brenda një periudhe të arsyeshme të formoj komisionet për vlerësimin dhe inventarizim e pasurisë. Këto komisione duhet të kryejnë një regjistrim dhe vlerësim të drejtë dhe të plotë të gjithë pasurisë në pronësi të komunës, si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Po ashtu, për të pasur një evidencë të saktë të stoqeve, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€, të gjitha regjistrimet duhet të bëhen në sistemin e-pasuria.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta, janë fond i vogël i parave që mbahen në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€). Komuna gjatë vitit 2018 ka shpenzuar për këtë qëllim 988€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Të arkëtueshmet

Meqenëse, komuna nuk lëshon asnjë lloj fature për tatime dhe taksa, ajo nuk ka llogari të arkëtueshme dhe nuk mban evidenca për to. Taksa për lëshimin e certifikatave të ndryshme janë pagesa me para në dorë përmes arkës me rastin e dorëzimit të kërkesës për certifikatë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 230,938€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga komuna.

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve

Gjetja Sipas nenin 5 të Rregullores Financiare të Ministrisë së Financave nr. 02/2013 Për raportimin e obligimeve të paplotësuara, të gjitha organizatat buxhetore janë të detyruara t'i raportojnë detyrimet e tyre ndaj Ministrisë së Financave ose Thesarit. Të gjitha detyrimet sipas kësaj politike duhet të bëhen përmes raporteve mujore. Zyrtarët nga sektori i financave e kanë neglizhuar këtë çështje edhe pse rekomandimi ynë për këtë është përsëritur gjatë dy viteve të kaluara.

Gjatë vitit 2018, komuna nuk kishte raportuar në baza mujore obligimet financiare në MF, siç kërkohet me rregullën financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore. Me tutje, Komuna, nuk mban libër të protokollit për pranimin e faturave.

Rreziku Mos raportimi i rregullt mujor i obligimeve, ose mos zbatimi i rregullave financiare, mund të rezultojë me pagesa të paplanifikuara nga buxheti i vitit të ardhshëm. Mos mbajtja e një libri të protokollit për faturat e pranuar, mund të rezultojë me vonesa të pagesave të faturave apo edhe me pagesa të dyfishta.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Niveli i qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial është mjaft sfiduese. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura. Njësia e Auditimit të brendshëm (NjAB) dhe Komiteti i auditimit (KA) nuk janë themeluar. Komuna, nuk kishte përmbushë as kërkesën e MF-së lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Organizatrat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj. Komuna nuk i posedon asnjërën nga këto plane/strategji.

Gjithashtu, edhe në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive në menaxhimin e buxhetit/shpenzimeve.

Me gjithë këto mangësi, komuna për sa i përket procedurave të prokurimit në përgjithësi ka shënuar progres dhe ka përmirësuar kontrollet, pasi nga shqyrtimi i dosjeve të prokurimit nuk është identifikuar ndonjë mangësi në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit në këtë fushë.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Organizatrat buxhetore janë të obliguara që të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e saj t'i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Një sistem i mirëfilltë i auditimit të brendshëm i ndihmon menaxhmentit në identifikimin e dobësive në menaxhimin financiar dhe kontrolleve të komunës. Kjo kontribuon në përmirësimin e kontrolleve të brendshme, arritjen e objektivave dhe përmirësimin e shërbimeve që ofron komuna.

Çështja B7 - Mos themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

- Gjetja** Përkundër rekomandimeve tona të përsëritura Komuna ende nuk ka arritur që të siguroj shërbimet e auditimit të brendshëm dhe nuk janë mbuluar as nga ndonjë organizatë tjetër. Kjo, për shkak se menaxhmenti i komunës nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur auditimit të brendshëm dhe përmirësimit të aktiviteteve të kontrollit të brendshëm të komunës.
- Rreziku** Mungesa e aktiviteteve të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje që t'i identifikojë dobësitë e kontroleve dhe të reagojë me kohë për eliminimin e tyre.
- Rekomandimi B7** Kryetari duhet të themeloj NjAB-në, me qëllim për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe e cila do të ndihmonte aktivitetet operative në vazhdim. Përveç kësaj ne sugjerojmë edhe themelimin/funksionimin e KA-së që t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe efikase ndaj problemeve operative të identifikuara.

Komuna, ende nuk e ka vendosur një sistem formal dhe efektiv të raportimit menaxherial. Forma dhe cilësia e raportimit të brendshëm aktual si të tilla nuk sigurojnë bazë për mbikëqyrje sistematike të aktiviteteve operative dhe variancave buxhetore.

Çështja B8 – Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Menaxhimi jo i duhur i proceseve në realizimin e buxhetit (vonesat në fillimin e projekteve), ka ndikuar suficitin buxhetor dhe atë kryesisht për investime kapitale. Menaxhimi jo i mirë i buxhetit ishte si pasojë e vlerësimit të dobët të nevojave dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme. Menaxhmenti, nuk raporton në baza mujore në MF për ecurinë e progresit të investimeve kapitale. Më tutje, menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative. Komuna, gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive.

Rreziku Kërkesat e llogaridhënies dhe raportimi financiar të cilësisë së pamjaftueshme, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta dhe shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit për projekte kapitale, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 ka rezultuar me 10 rekomandime. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi, ku kishte paraqitur detajet e masave dhe aktiviteteve se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Raporti i auditimit nuk ishte diskutuar në Kuvendin Komunal, ashtu siç është rekomanduar në raportin e vitit të kaluar.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit tonë, nga 10 rekomandime të dhëna vetëm një rekomandim ishte në proces të zbatimit, një rekomandim i mbyllur i pazbatuar, ndërsa pjesa tjetër e rekomandimeve nuk ishin trajtuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Tabelën 4- Përmbledhja e rekomandimeve.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të ndërmerr veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet dhe për të siguruar menaxhim të duhur të pasurive dhe të kontratave të dosjeve të punonjësve. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Ky rekomandim kishte të bënte me mangësitë e gjetura lidhur me menaxhimin e pasurisë dhe të personelit dhe që kanë ndikuar në theksim të çështjes tek opinioni i auditimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
2	Procesi i buxhetit	Kryetari, duhet të siguroj që performanca buxhetore monitorohet vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson pengesat dhe vështirësitë për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Edhe këtë vit, nuk ka progres të theksuar në realizimin e buxhetit, i cili ishte vetëm 68%.	Rekomandim i pa zbatuar.
3	Të hyrat	Kryetari, duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike, si dhe e njëjta të aprovohet në Kuvendin komunal. Po ashtu, të siguroj zbatimin e ligjit për tatimin në pronë dhe atij të ndërtimit, i cili ka për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave minimale ligjore, dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	Komuna ende nuk ka marrë ndonjë veprim konkretë për zbatimin e rekomandimit, si pasojë e situatës administrative në komunë.	Rekomandim i pa zbatuar.

4	Menaxhimi i personelit	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për t'i adresuar në mënyrë urgjente çështjet e përmendura më lart, ashtu që komuna të zbatoj Rregulloren e brendshme për strukturën organizative dhe që pozitat kyçe të plotësohen me personelin adekuat dhe me një përkrahje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi. Më tutje, pozitat me UD, duhet të trajtohen dhe rregullohen sipas kërkesave ligjore. Po ashtu, të gjithë të punësuarit të kenë kontratë të vlefshme të punës.	Menaxhmenti ka miratuar Rregulloren për organizimin e brendshëm, strukturën organizative, por nuk ka filluar së zbatuari. Derisa nuk është zbatuar pjesa për azhurnimin e dosjeve dhe kontratave të punëtorëve.	Rekomandim Pjesërisht i zbatuar.
5	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet të siguroj që do të përcaktohen qartë mekanizmat se si do të monitorohen dhe menaxhohen subvencionet. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.	Menaxhmenti nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për zbatimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
6	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmarr veprime konkrete për të siguruar që brenda një periudhe të arsyeshme të formoj komisionet për vlerësimin dhe inventarizim e pasurisë. Këto komisione duhet të kryejnë një regjistrim dhe vlerësim të drejtë dhe të plotë të gjithë pasurisë në pronësi të komunës, si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Po ashtu, për të pasur një evidencë të saktë të stoqeve, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€, të gjitha regjistrimet duhet të bëhen në sistemin e pasurisë.	Menaxhmenti nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për zbatimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
7	Obligimet	Kryetari, duhet të forcoj kontrollat lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Më tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.	Komuna edhe këtë vit nuk ka bërë raportimet mujore lidhur me obligimet si dhe nuk ka regjistër të protokollit të faturave.	Rekomandim i pa zbatuar.

8	Progresi i zbatimit të rekomandimeve	Kryetari, duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm. Kjo duhet të bëhet nga stafi përgjegjës për secilën fushë, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	Menaxhmenti edhe pse ka përgatitur një plan veprimi për implementimin e rekomandimeve nga vitet e kaluara nuk ka treguar seriozitet në implementimin e tyre.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.
9	Sistemi i AB	Kryetari, duhet të themeloj NjAB-në, me qëllim për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe e cila do të ndihmonte aktivitetet operative në vazhdim. Përveç kësaj ne sugjerojmë edhe themelimin/funksionimin e KA-së që t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.	Menaxhmenti nuk ka ndërmarr asnjë veprim në zbatimin e këtij rekomandimi.	Rekomandim i pa zbatuar.
10	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit për projekte kapitale, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Menaxhmenti nuk ka ndërmarr asnjë veprim në zbatimin e këtij rekomandimi.	Rekomandim i pa zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV dhe opinionin e auditimit	Kryetari duhet të ndërmerr veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet dhe për të siguruar menaxhim të duhur të pasurive dhe të kontratave të dosjeve të punonjësve. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		

2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore monitorohet vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson pengesat dhe vështirësitë për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.
3	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Vendimet gjyqësore	Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për zgjidhjen e statusit të punëtorëve të zjarrfikësve, njëkohësisht këtë situatë ta trajtojë me organet tjera kompetente dhe të eliminojnë kontestet e tilla, në mënyrë që mos vie deri tek dëmtimet buxhetore për pagesën e ngarkesave shtesë të shpenzimeve për procesin gjyqësor. Po ashtu, Kryetari duhet që të ketë njësinë e saj ligjore, respektivisht një zyrtar ligjor në mënyrë që në konteste gjyqësore të ketë përfaqësim të mbrojtjes ligjore. Më tutje, duhet të kërkoj nga Thesari që të zbatoj rregullat financiare që të mos kryhen pagesa direkte pa u zbatuar procedura për obligimet e pa paguara.
4	Të hyrat vetjake	Kryetari, duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike, si dhe e njëjta të aprovohet në Kuvendin komunal. Po ashtu, të siguroj zbatimin e ligjit për tatimin në pronë dhe atij të ndërtimit, i cili ka për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave minimale ligjore, dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.
5	Paga dhe Mëditje	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për t'i adresuar në mënyrë urgjente çështjet e përmendura më lart, ashtu që komuna të zbatoj Rregulloren e brendshme për strukturën organizative dhe që pozitën kyçe të plotësohen me personelin adekuat dhe me një përshkrim të qartë të detyrave dhe përgjegjësi.
6	Subvencio net dhe Transferet	Kryetari duhet të siguroj që do të përcaktohen qartë mekanizmat se si do të monitorohen dhe menaxhohen subvencionet. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.
7	Investime kapitale. Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve	Kryetari duhet që të sigurojë se planifikimi i buxhetit për projekte kapitale të jetë në përputhje me shpenzimet të cilat konsiderohen si investime kapitale dhe të jenë të realizuara sipas destinimit në kategori ekonomike përkatëse. Në raste konkrete të bëhet ridestinimi i mjeteve për shpenzim sipas kërkesave të planit kontabël.
8	Investime Kapitale. Vonesat në ekzekutim të projekteve	Kryetari duhet të sigurohet që për projekte përkatëse të kryhet paraprakisht studim fizibiliteti, të siguroj që projekti të fillojë në kohë optimale dhe që planet për kohëzgjatjen e punimeve të jenë të planifikuara në përputhje me mundësitë reale. Po ashtu, gjatë përgatitjes së Propozim-projekteve kapitale komplekse të gjej modalitete të përshtatshme se si të ekzekutohet projekti në mënyrë që të evitohen vonesa në fillimin dhe kryerjen e atyre projekteve.
9	Obligimet e pa paguara	Kryetari duhet të forcoj kontrollat lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.

10	Sistemi i Auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të themeloj NjAB-në, me qëllim për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe e cila do të ndihmonte aktivitetet operative në vazhdim. Përveç kësaj ne sugjerojmë edhe themelimin/funksionimin e KA-së që t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.
11	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit për projekte kapitale, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi

**KOMUNA E ZUBIN POTOK
OPŠTINA ZUBIN POTOK
MUNICIPALITY OF ZUBIN POTOK**

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Zubin Potokut, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Stevan Vulovic

Kryetar i Komunës së Zubin Potokut,



Data: 10.Prill.2019, Prishtinë,